

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Winter 1-2021

NDIKIMI DHE ETIKA E KONTABILISTËVE NË EVAZION FISKAL NË KOSOVË

Nafije Berisha

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)

Recommended Citation

Berisha, Nafije, "NDIKIMI DHE ETIKA E KONTABILISTËVE NË EVAZION FISKAL NË KOSOVË" (2021).
Theses and Dissertations. 2105.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2105>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

**NDIKIMI DHE ETIKA E KONTABILISTËVE NË EVAZION FISKAL
NË KOSOVË**

Shkalla Bachelor

Nafije Berisha

Janar/2021

Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome
Viti akademik 2017-2018

Nafije Berisha

**NDIKIMI DHE ETIKA E KONTABILISTËVE NË EVAZION FISKAL
NË KOSOVË**

Mentor: Dr. Sc. Mustafë Hasani

Janar/2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Kërkimi shkencor bazohet në aplikimin e metodave shkencore për të siguruar informacion shkencor dhe teori të caktuar për të shpjeguar fenomene dhe çështje specifike të sistemit tatimor, natyrës, mjedisit, biznesit dhe individëve që na rrethojnë. Qëllimi primar i kërkimit të aplikuar është zbulimi, interpretimi dhe zhvillimi i metodave dhe sistemeve për zhvillimin e dijeve humane në një rang të gjerë të çështjeve shkencore të botës. Duke pasur parasysh përpjekjet administratave taksambledhëse të një shteti që vazhdimisht synon të mbledh të gjitha taksat dhe tatimet nga të gjitha subjektet të cilat detyrohen në bazë të ligjit dhe rregulloreve fiskale, dhe në anën tjetër qëndrojnë përballë, ndoshta jo pak nga individë apo biznese, të cilat janë të gatshme të mos paguajnë apo të paguajnë pjesërisht taksat dhe tatimet që janë të detyruar me ligj. Kjo përballje në mes tyre bënë që administratat taksambledhëse gjithmonë të gjejnë mekanizma të rinj, së pari të parandalojnë dhe së dyti që të mbledhin taksat e humbura, kurse në anë tjetër individët, bizneset të caktuara bëjnë përpjekje të gjejnë mënyrat e tyre për të shkaktuar evazion fiskal dhe për të gjetur hapësirat ligjore për të shkaktuar shmangie nga detyrimet tjera tatimore në të mirë të tyre. Nga ky studim është bërë matja e nivelit të evazionit fiskal në Kosovë dhe janë vlerësuar disa nga faktorët që kanë lidhje apo ndikojnë në evazionin fiskal.

Hulumtimi është kryer përmes metodës sasiore dhe cilësore, ku mbledhja e të dhënave është bërë përmes pyetësorëve të strukturuar dhe intervistave. Numri i respondentëve në këtë hulumtim kanë qenë pasur 12 femra dhe 38 meshkuj, apo shprehur në %, 24 % me 76 %.

Fjalët kyqe: **Evazoni Fiskal, Administrata Tatimore, Tatimet.**

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Falënderoj thellësisht dhe u jam mirënjohëse përjetësisht familjes sime të ngushtë që janë personat më të veçantë në jetën time të cilët ishin afër meje në çdo hap të jetës sime duke më ofruar mbështetje të pa kusht emocionale dhe financiare.

Falënderim i veçantë shkon për mentorin e temës Dr.Sc. Mustafë Hasani për ndihmën profesionale dhe mbështetjen e çmuar që më ofroi përgjatë gjithë punës së këtij punimi me këshillat e dhëna, mirëkuptim, durim dhe motivimi nga mentori, arrita në përfundim të suksesshëm të punimit pa të cilin ky studim nuk do të ishte i mundur, ky kontribut do të jetë udhërrëfyes në karrierën time profesionale.

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, falënderoj shoqërinë time për këshillat dhe përkrahjen e vazhdueshme, jam me fat që janë pjesë e jetës sime.

Sinqerisht faleminderit të gjithëve do jem mirënjohëse gjatë gjithë jetës sime.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	I
MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME	II
LISTA E TABELAVE	IV
LISTA E FIGURAVE.....	V
FJALORI I TERMAVE	VI
1 HYRJE.....	1
2 SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	5
2.1 Evazioni fiskal	5
2.2 Evazioni Fiskal në Sektor të Ekonomisë	8
2.3 Etika dhe Kodi i Etikës së kontabilistëve – IFAC - Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve.....	11
2.4 Profesionistët e kontabilitetit përballë problematikave të evazionit fiskal dhe veprimeve të tjera të paligjshme.....	13
2.5 Masat parandaluese dhe luftimi i ekonomisë informale	15
3 Te Hyrat Tatimore te grumbulluara nga ATK dhe DOGANA	17
4 DEKLARIMI I PROBLEMIT	22
5 METODOLOGJIA	23
6 MBLEDHJA E TE DHENAVE DHE REZULTATET.....	24
7 DISKUTIME, PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	30
8 REFERENCAT	32
9 APPENDIXES	34
Pyetëtori	34

LISTA E TABELAVE

<i>Tabela 1. Te hyrat sipas llojeve te tatimeve dhe te hyrat tjera jo tatimore</i>	<i>19</i>
<i>Tabela.2. Normat tatimore në Kosovë</i>	<i>21</i>
<i>Tabela.3. Evazoni fiskal në Kosovë është shumë i lartë?</i>	<i>25</i>
<i>Tabela.4. Evazoni Fiskal është më i lartë te bizneset e vogla?</i>	<i>25</i>
<i>Tabela.5. Bizneset me qarkullim dhe numër të madhe të puntorëve kan më pak evazion fiskal?</i>	<i>26</i>
<i>Tabela.6. Evazoni më i madh është në sektorin e hotelerisë?</i>	<i>26</i>
<i>Tabela.7. Etika fiskale në mbajtjen e librave dhe kontabiliteti është i imponuar nga biznesi?</i>	<i>27</i>
<i>Tabela.8. Kontabilisti ka ndikimi në evazion fiskal?</i>	<i>27</i>
<i>Tabela.9. Biznesi i pranon keshillat për etik fiskale dhe mbajtjen librave dhe kontabiliteti në menyre korrekte?</i>	<i>28</i>
<i>Tabela.10. A mendoni se kontabilisti mund te ndikoj në zvogelimin e evazionit fiskal?</i>	<i>28</i>
<i>Tabela.11. A mendoni se ndëshkimi edhe i kontabilistit për evazion fiskal mundet me kontribu në zvoglimin e shmangjeve tatimore?</i>	<i>29</i>
<i>Tabela.12. A mendoni se evazoni fiskal po ndihmohet edhe nga inspektorët që mbajnë libra dhe kontabilitet?</i>	<i>29</i>

LISTA E FIGURAVE

<i>Figura 1. Struktura e te hyrave ne te hyrat e përgjithshme.....</i>	<i>17</i>
<i>Figura 2. Profesioni i responentëve</i>	<i>24</i>
<i>Figura 3. Evazioni fiskal në Kosovë.</i>	<i>25</i>
<i>Figura 4. Evazioni në bizneset e vogla.....</i>	<i>25</i>
<i>Figura 5. Bizneset me qarkullim.....</i>	<i>26</i>
<i>Figura 6. Evazioni në sektorin e hotelerisë.....</i>	<i>26</i>
<i>Figura 7. Etika Fiskale.....</i>	<i>27</i>
<i>Figura 8. Ndikimi i Kontabilistit në evazion fiskal.....</i>	<i>27</i>
<i>Figura 9. Këshillat për biznesin.</i>	<i>28</i>
<i>Figura 10. Ndikimi i Kontabilistit</i>	<i>28</i>
<i>Figura 11. Zvoglimi i shmangjeve tatimore</i>	<i>29</i>
<i>Figura 12. Ndikimi i inspektorëve.</i>	<i>29</i>

FJALORI I TERMAVE

IFAC- International Federation of Accountants.

ATK – Administrata tatimore e Kosovës.

TAK- Tatimit në të Ardhurat e Korporatave.

TAP- Tatimit në të Ardhurat Personale.

TVSH-Tatimit mbi Vlerën e Shtuar

OECD -Organisation for Economic Co-operation and Development

BPK- Bruto Produkti Kombëtar

BPV- Bruto Produkti Vendor

LPG- Liquified Petroleum Gas

BE- Bashkimi Evropian

KASH- Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

MPB- Ministria e Punëve Mbrendshme

SHPK- Shoqëri me Përgjegjësitë kufizuar

TI- Teknologji Informative

UE- Unioni Evropian

GVA- Gross Value Added

1 HYRJE

Definicionet për qëllime të kësaj teme të diplomes janë konsekuente me konceptet e përgjithshme të OECD/së. Ekonomia joformale përbëhet nga Ekonomia e hirtë joformale dhe Ekonomia e zezë joformale të cilat janë të kalkuluar me metodat indirekte makro/ekonomike.

Ekonomia joformale e hirtë përbëhet nga aktivitetet legale të cilat fshehën me paramendim me qëllim të shmangies së tatimit, përputhshmërisë me rregullat dhe/apo kontributet e sigurimit social. Të hyrat nga Ekonomia joformale e hirtë duhet të taten.

Ekonomia joformale e zezë përbëhet nga të ardhurat e shmangies/fshehjes së tatimit dhe kontrabandës së të mirave (mallrave) ligjore. Ekonomia e zezë përbëhet nga tregtia me drogë, prostitucioni, kontrabanda e mallrave ligjore dhe aktivitetet tjera kriminale. Profiti i krijuar me aktivitetet të tilla është jo ligjor. Të hyrat nga burimet e tilla janë të pa tatueshme dhe duhet të konfiskohen si të ardhura nga krimi.

Studime të ndryshme të bëra në Kosovë përmbajnë konstatime interesante për Ekonominë e hirtë joformale. Ekonominë e zezë joformale (profite të krijuara nga aktivitetet ligjore në të cilat të hyrat duhet të taten) dhe ekonominë e zezë (profite të krijuara nga aktivitetet joligjore janë të pa tatueshme dhe si të tilla duhet të konfiskohen).

Disa nga kalkulimet sipas këtyre studimeve përmes metodave indirekte makro-ekonomike, metoda e përputhshmërisë tatimore të ekonomisë shtëpiake, janë përpjekur të kalkulojnë shtrirjen e ekonomisë joformale në Kosovë, që për kushtet Kosovare janë mjaftë shqetësuese.

Janë të njohura tri lloje vijuese të metodave për njësimin e përmasave dhe zhvillimin e ekonomisë joformale : Qasja direkte, qasja indirekte dhe qasja modulare.

Metoda direkte e njësimit të ekonomisë joformale është përgjithësisht qasje mikro/ekonomike duke përdorur hulumtimet apo metodat e auditimit të tatimit kjo metodë mund të përdoret për njësimin edhe të ekonomisë së hirtë dhe po ashtu edhe të asaj të zezë.

Metoda indirekte e njësimit të ekonomisë joformale është përgjithësisht makro/ekonomike pra hulumtime bazuar nëqarkullimin e monedhave letër në ekonomi,shpenzimeve, konsumit,konsumit të energjisë dhe konsumit të përgjithshëm familjar.

Metoda modulare merret me shkaqet e shumëfishta (p.sh ngarkesa tatimore, treguesit e zhvillimit të tregut prodhues hetimet dhe sondazhet mbi sipërmarrësit, punëtorët, anketimet hulumtimet bazuar në variabël tëndryshme.

Shkalla gjithnjë sipas këtyre studimeve sillet prej 30.00 % deri në 40.00 % e konstatuar si minimumi i ekonomisë joformale të që në vlerë absolute lëvizë ndërmjet 700 e 900 milion euro për vit e ku dëmet nga mospërputhja me rregullat tatimore kapin vlerën 300 deri 450 milion euro.

Të dhënat e ATK-së për subjektet e kontrolluara gjatë viteve 2005-2010 japin një pasqyrë që edhe më shumë e fuqizon këto llogaritje te ekonomisë joformale Tatimi shtesë i konstatuar nga të hyrat e pa deklaruar në vitet 2005 – 2010 sillen deri në 200 milion €. Ky tatim shtesë i përket profiteve të pa deklaruar të ekonomisë joformale, të cilat u takojnë tatimeve dhe kontributeve pensionale.

Dëmet e shkaktuara në vlerë absolute monetare krijojnë çrregullime edhe në sferat tjera të jetës që e bëjnë edhe më shqetësuese nivelin e ekonomisë joformale në Kosovë:

- a) Dobëson të hyrat tatimore për buxhetin e Kosovës,
- b) Dobëson aftësinë financiare për të prodhuar shërbime publike,
- c) Zhvillohet garë jo e drejtë ne konkurrencën ekonomike në treg,
- d) Krijon zbehje të motiveve për investimet e kapitalit të huaj në Kosovë,
- e) Realizim të kontratave joreale të të punësuarve dhe shmangie sistematike të kontributeve pensionale, pasiguri sociale dhe mungesë të beneficioneve për punëtorët,
- f) Deklarime të ulëta të fitimeve reale,
- g) Ulje të besimit tek bankat dhe dobësimin e sistemit kreditor,

Shkalla e larte e ekonomisë joformale shpie tek rrethi vicioz jo vetëm në Kosove por edhe në vende të tjera

E njëjta është e dëmshme për interesat fiskale të qeverisë dhe për infrastrukturën shoqërore, sepse i dobëson të hyrat tatimore duke dobësuar kështu aftësinë për të prodhuar shërbime publike. Ekonomia joformale po ashtu e pengon seriozisht konkurrencën e drejtë duke zvogëluar garën fer transparente dhe lojale, në jetën afariste kostoja e prodhimit të

kompanive të cilat i përmbahen ligjit tatimor është e lartë në krahasim me ato të cilat i shmangen tatimit çka krijon një konkurrencë jo lojale të pandershme dhe të dëmshme për tatimpaguesit e rregullt. Përdorimi i kontratave joformale të punës dhe shmangia e sistematike e kontributeve për sigurim social do ta dobësojë mbrojtjen e punëtorëve dhe do t'i zvogëlojë beneficionet e tyre sociale. Kjo natyrisht do t'i ndërrojë qëndrimet e përgjithshme në shoqëri, po ashtu do ta dobësojë seriozitetin e sistemit financiar. Deklarimi i ultë i profitit dëmton besimin ndërmjet kompanive dhe bankave, çka shpie gjer tek tregu i paefektshëm kreditor. Kjo dekurajon investimet e huaja.

Kalkulimet ndërkombëtare përkitazi me ekonominë joformale

Në nivelin ndërkombëtar njehsimi i ekonomisë joligjore ka rëndësi të madhe. Kjo posaçërisht ka të bëjë me UE një pjesë e madhe e financimit të saj mbulohet nga kontributet e vendeve anëtare në formë të taksës e cila është e përcaktuar në bruto produktin kombëtar (BPK). Ato vende të cilat kanë ekonomi të vogël joligjore apo të cilat tani më e kanë përfshirë ekonominë joligjore në statistikat e tyre zyrtare janë më reale se sa vendet tjera në njehsimin e shtrirjes së ekonomisë joligjore në shtetet anëtare të UE-së të cilat nuk e kanë treguar në statistikat e tyre pjesëmarrjen e ekonomisë joformale sepse në të kundërtën ato do të paguajnë pjesë jo proporcionale të taksës së përgjithshme të BPK-së.

Në vlerësimet e Komisionit Evropian mbi punën e zezë vërehen ndryshime të konsiderueshme varësisht nga metoda e evoluimit. Pavarësisht nga kjo, vendet anëtare mund të klasifikohen në grupe të ndryshme sipas sasisë së punës së zezë. Vendet skandinave, së bashku me Irlandën, Austrinë dhe Holandën, ishin në kategorinë më të mirë ku efekti i punës së zezë vlerësohej rreth 5% të BPK-së. Në anën tjetër të shkallës ishin Italia dhe Greqia ku shifra korresponduese ishte 20%. Në mes qëndronin dy grupe: Britania e Madhe, Gjermania dhe Franca ishin në mes të radhitjes Belgjika dhe Spanja kishin përqindje më të madhe.

Në raportin e Komisionit Evropian vlerësimet mbulonin sasinë e punës së zezë, por ato nuk përfshinin ekonominë e hirtë të gjerë, për shembull ato aktivitete që lidhen me tregtinë apo investimet.

Shumica e Këtyre studimeve janë përcjellur edhe me rekomandime specifike kryesisht ato vlejne për vendet të cilat nuk kanë ndonjë përvojë të pasur në luftën kundër ekonomisë joformale dhe të cilat kanë për qëllim të fuqizimin e kapaciteteve institucionale për luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave dhe korrupsionit.

Në Republikën e Kosovës Përgjegjësi e ATK-së është luftimi i efekteve të ekonomisë joformale (e hirtë dhe e zezë) e cila është e angazhuar që të jetë sa më efikase dhe të zhvilloj aktivitete në minimizimin e shtrirjes së aktiviteteve të tilla. Nga rekomandimet e paraqitura në këtë studime e qe mund te jenë udhërrëfyes i mirë i cili duhet dhe do të përkrahët nga Qeveria, të filloj implementimi i tyre, të krijohen grupet punuese që do të hartojnë strategjinë dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj strategjie.

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Evazioni fiskal

Teoria ekonomike ka njohur prej kohësh rëndësinë themelore të të ardhurave publike për kryerjen e të gjitha funksioneve që ka një shtet. Tatimet, si përcaktuese teorike e të ardhurave publike, përfaqësojnë një nga vlerat themelore të funksionimit të shtetit modern. Ashtu si të ardhurat publike, tatimet janë objekt i hulumtimit nga shumë studiues dhe ekspertë vendas dhe të huaj. Sidoqoftë, tema dhe çështjet e efikasitetit të mbledhjes së tatimeve dhe ekonomia informate apo evazioni fiskal është shtjelluar nga shumë autor.

Në librin e tij "Financat Publike", (D, 2000), (Sabahudin Komoni, 2008) merren me temën e financave publike në librat dhe artikujt e tyre. (Joseph Stiglitz, 2004) me librin e tij "Ekonomia e sektorit publik" është një nga autorët më të rëndësishëm në botë që merret me çështjen e financave publike dhe në librat dhe artikujt e tij të shumtë shtjellon këtë temë. (Barry Eichengreen, 2003) në artikullin e tij përcakton institucionet e rëndësishme për stabilitetin fiskal. (Victor Thuronyi, 2003) në librin e tij Ligji i Taksave Krahasues krahason ligjet tatimore të vendeve individuale të botës. (Asprey, 2001) në artikullin e tyre studiojnë funksionimin e një komiteti të kontrollit tatimor. Në artikullin "Reformat e ardhshme të taksave në vendet para anëtarësimit në Bashkimin Evropian: rastet e Kroacisë dhe Serbisë" (Christopher Nobes, 2000) në librin e tij përcakton parimet, politikat dhe praktikatat e ekonomisë së taksave.

(Judith Freedman, 2008) në artikullin e tyre trajtojnë një qasje alternative ndaj rrezikut të taksave dhe shmangies së taksave. (Linda Peter Szerenyi, 2003) Peter Szerenyi në librin e tij merret me qasjen ndaj ekonomisë gri në vendet e OECD. (Agnar Sandmo, 2012) Sandmo A. në artikullin e tij merret me konceptime teorike të ekonomisë gri, (Kalvin Kulic, 1999) në librin e tij "Evazioni fiskal dhe kontrabanda" merret me përcaktuesit kryesorë të këtyre fenomeneve negative në një shoqëri. Në artikullin e (James

Alm, 2012)merret me matjen, shpjegimin dhe kontrollimin e evazionit fiskal. (James Alm, 2012)dhe (B, 2012)në artikullin e tyre theksojnë rëndësinë e etikës dhe në përputhje me rrethanat ndikimin e pajtueshmërisë së taksave dhe moralit tatimor.

Evazoni fiskal përfshin të gjithë rezistencën individuale, por edhe kolektive të personave fizikë apo juridikë, mbi të cilët rëndon çdo lloj detyrimi i ligjshëm për të kontribuar në të hyrat publike. Evazion fiskal sipas shkencës së financave, lidhet me të gjitha ato veprime që kanë për qëllim të zvogëlojnë ose të eliminojnë kontributin fiskal në arkën e shtetit prej qytetarëve ose subjekteve, duke shkelur dispozita dhe norma fiskale specifike. Evazoni fiskal mund të përkufizohet si çdo veprimtari kriminale ose çdo vepër e pandershmërisë e dënueshme me gjobë civile që ka për qëllim të zvogëlojë incidencën tatimore, dhe varet nga strukturat ekonomike dhe tatimore, llojet e të ardhurave dhe qëndrimet shoqërore(Daniela Mineva, D.M and Stefanov R. Vitosha Research EOOD, 2018). Koncepti i evazionit fiskal në literaturën ekzistuese është përshkruar nga një perspektivë e financimit ekonomik ose publik dhe shumë pak studime kanë diskutuar çështjen nga një këndvështrim filozofik ose etik. Modeli themelor teorik i evazionit fiskal është një aplikim i drejtpërdrejtë i zgjedhjes individuale nën pasiguri dhe problemi me të cilin përballlet një individ është nëse duhet të shmanget apo jo një pjesë e detyrimit të tij ligjor tatimor, duke pasur parasysh se ekziston ndonjë mundësi e kapjes nëse ai vendos të shmanget(Charles T Clotfelter, 1983). Evazoni fiskal është forma më e shpeshtë e informalitetit. Ai nuk nënkupton thjesht shmangien nga pagimi ose nga shlyerja e tatimeve. Ai përfaqëson shmangien nga çdo lloj detyrimi fiskal të parashikuar nga kuadri ligjor i një shteti.

Evazoni fiskal ka një efekt shkatërrues ndaj politikës fiskale të qeverisë duke i shkaktuar Shtetit një humbje jo të vogël nga të ardhurat fiskale të tij(Valerie Braithwaite, 2017).

Pra mbi Evazonin fiskal ka njënumër te konsiderueshëm autoresh te cilët merren me çështjen në fjalë dhe shtjellojnë tema jo vetëmpër të elaboruar efektin e tyre negativpërshoqërinë dhe shtetin por njëkohësisht gjenden edhe artikuj te ndryshëm shkencor te cilët japin rekomandime se si te luftohen dukurit e tilla dhe si duhet institucionet përgjegjëse apo agjencitë e te hyrave te ju qasen metodologjive te caktuara për te luftuar dukurin me qellim te zvogëlimit te evazionit fiskal dhe ekonomisë informale e

që në mënyrë indirekte ndikon në rritjen e buxhetit të shtetit një strategji mirë e organizuar kundër evazionit fiskal

Evazioni fiskal është i mundshëm përmes disa veprimeve që kryhen në situata shumë të ndryshme: në kryerjen e operacioneve të shitjes ose të shërbimeve pa lëshuar faturën e rregullt për veprimin e kryer ndaj qytetarit/konsumatorit (e ashtuquajtura shitje në “të zezë”) hartimi i deklarimeve fallso të të ardhurave me pasojë deklarimin fiskal të mangët ose të gabuar që sjell derdhjen e munguar të detyrimeve reale, kryerja e një aktiviteti ekonomik jashtë çdo rregulle: për shembull, “pas pune në të zezë” nga nënpunësit (publik ose privat), megjithëse në raporte të rregulla pune, marrja e një pjesë të shpërblimit në formë të pa dokumentuar, për pasojë të pataksueshme, përmes parave në dorë (forma tipike e integracionit ose rikompensimit të përdorur në ndërmarrjet e mikro apo të vogla), pasi t’i nënshtrohet marrëveshjes midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, ndryshimi I natyrës së zërave që shoqërojnë dëftesën e pagës, për shembull, duke dhënë transferta fallso (që nuk janë të taksueshme) me qëllim që të eliminojnë zërat e taksueshëm (për shembull, pagesat suplementare), marrëveshje të fshehta me klientin e ndërmarrjes ose punëtorin autonom për të zvogëluar ose evituar krejtësisht paraqitjen e faturave ose ndryshimin e natyrës së zërave, xhirimi i dokumenteve fiskale subjekteve që nuk janë reale në mënyrë që këto të kontabilizohen në kosto (në mënyrë për të zvogëluar në mënyrë fiktive shumën e taksueshme), mospagimi i taksave ose detyrimeve për përfitimin e shërbimeve ose moskryerja e kërkesave të detyrueshme, për shembull mos pagesa e taksës së TV, të taksave lokale të shërbimeve, etj. Çështja e të mirave publike në këmbim të taksave i shton një dimension shoqëror problemit, sepse sasia e të ardhurave në dispozicion, dhe sasia dhe cilësia e të mirave publike të ofruara, nuk varet vetëm nga zgjedhja e tatimpaguesit të vetëm për të paguar ose shmangur taksat . Përkundrazi, tatimpaguesit janë të ndërvarur, pasi rezultatet e tyre në lidhje me të mirat publike që ata ndajnë janë një funksion i zgjedhjeve të tyre të kombinuara të sjelljes. Tatimpaguesit individualë mund të zgjedhin të shmangin taksat në mënyrë që të maksimizojnë rezultatet e tyre personale dhe të gëzojnë akoma pjesën e tyre të së mirës publike, e cila nuk ndikohet nga zgjedhjet e vetme me defekt. Sidoqoftë, nëse shumë tatimpaguesit vendosnin ta bëjnë këtë, të ardhurat do të binin

në një nivel ku mallrat e caktuara publike nuk do të ishin më të përballueshme dhe rezultatet e të gjithëve do të zvogëloheshin.

Edhe pse barra tatimore llogaritet një ndër me të ulëtat në rajon, prapë se prapë evazioni fiskal, informaliteti ekonomik dhe korrupsioni janë shumë prezent në ekonominë Kosovare dhe llogaritën si shkaktarët kryesor që ndikojnë në zvogëlimin e të ardhurave tatimore dhe rritjes ekonomike në përgjithësi, ku qytetarët disa prej tyre dhe nuk mund ti përballojnë pagesave të normave dhe se besimi në shtet ndërlihet me besimin në qeveri, parlament dhe besimin në sistemin legal të tatimit. Veprimet nga shteti në të mirë të qytetarëve, janë të destinuara të rrisin qëndrimet pro pagesës së tatimeve. Nëse një kompani shet ose prodhon produkte dhe shërbime brenda tregut të Kosovës dhe i paguan të gjitha taksat në buxhetin kombëtar, megjithatë ka kompani të tjera që merren me kontrabandë dhe evazion fiskal dhe nuk paguajnë detyrimet e tyre fiskale ndaj shtetit, dhe ato janë shumë më konkurruese sesa kompanitë serioze.

Niveli i lartë i evazionit fiskal pengon jashtëzakonisht zhvillimin ekonomik, mënyrën e zhvillimit të konkurrencës së lirë, tërheqjen e investimeve strategjike në energji, infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi, dhe përkeqëson koston e jetës së njerëzve gjithashtu. Një nga pengesat kryesore për të drejtuar një biznes në Kosovë është prania e evazionit fiskal dhe informalitetit. Evazioni fiskal komplikon stabilitetin fiskal dhe social të vendit, kështu prania më e madhe e ekonomisë informale dhe evazionit fiskal nënkupton më pak të ardhura në buxhetin e shtetit. Një gjë e tillë shkakton një klimë të pafavorshme për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe sundimin e ligjit, nga ana tjetër krijon një klimë fitimprurëse për krimin financiar, trafikimin e paligjshëm, qarkullimin e parave të ndyra. Investimi dhe pastrimi i parave të tilla inkurajon informalitetin e ekonomisë, e cila është strehë e krimit dhe ngadalë bëhet pengesë serioze për zhvillime të mëtejshme që kërcënojnë rendin publik dhe qytetarët.

2.2 Evazioni Fiskal në Sektor të Ekonomisë

Evazoni fiskal në Kosovë është i shtrirë në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe mënyrat e shmangieve tatimore janë të ndryshme duke filluar nga mos deklarimi i punëtorëve (ose mbajtja e punëtorëve në të zezë të pa lajmruar në listat të rregullta) pastaj ulja e shpenzimeve mosdeklarimet e qarkullimit real duke e zvogëluar shumën reale të shitjeve. Gjithashtu mbajtja e mallrave të paevidentuara në libra ose mbajtja e mallit në të zezë me qëllim që i njejtë të shitet pa u deklaruar dhe pa e paguar tatimin. Janë shumë mënyra të mbajtjes së librave dhe regjistrimeve jo në rregull dhe në përputhje me ligjin. Të gjitha këto shmangje tatimore apo funksionim të ekonomisë jo formale është prezent në sektor të ndryshëm. Në vazhdim një përshkrim mbi evazionin fiskal në sektor si Bujqësia, ndërtimataria, tregtia me shumicë etj.

Bujqësia është aktiviteti kryesor në Kosovë pasi që pjesa më e madhe e popullsisë (rreth 60%) jeton në zona rurale. Realiteti i aktivitetit ekonomik në këtë sektor karakterizohet nga një numër shumë i lartë i fermave (80%) të madhësisë shumë të vogël (me pak se 2 ha), të cilat kanë në përdorim rreth 30% të tokës së punueshme. Në anën tjetër, pjesa e mbetur prej 20% e fermave me madhësi prej më shumë se 2 ha kanë në përdorim rreth 70% të tokës dhe sipërfaqes së punueshme. Nivele mesatare absolute të të ardhurave nga kapitali dhe paga, edhe nën supozimin se këto mbledhen tek të njëjtat familje, janë nën pragun minimal të tatueshëm në Kosovë. Rrjedhimisht, humbjet totale nga TAP dhe TAK në bujqësi, pylltari dhe peshkim vlerësohet të jenë të ulëta, përkatësisht jo më shumë se 2 mil€ gjithsej. Ndonëse kjo degë e ekonomisë nuk kontribuon shumë sa i përket të ardhurave fiskale, kontributi në të ardhurat totale të ekonomive familjare për metodologjinë tonë përbën njërin nga faktorët më të rëndësishëm që kontribuojnë në absorbimin e konsumit total të ekonomive familjare. (European, 09.11.2017)

Përfitimet në Sektorin e ndërtimtarisë radhiten ndër normat më të larta të Kthimit të Aseteve (KA) në Kosovë krahasuar me trandë të globale dhe të Evropës Perëndimore që është 35% e që do të thotë se periudha e kthimit të investimit është më e shkurtër se 3 vjet ky numër është së paku 2 herë më i lartë se trendi global dhe ai i BE-së. Aktiviteti në këtë sektor karakterizohet nga përpjesëtime të tjera financiare që gjithashtu janë jo normale. Përpjesëtimi Shitje/Kapital (2.6) është i krahasueshëm me normën globale (2.5) ndërkohë

që përpjesëtimi Borxh/Pasuri nuk është më shumë se 23%, që është shumë më e ulët se mesatarja e nivelit global me 50%. Nisur nga këto raporte, niveli i ulët i kreditimit të sektorit gjithashtu është habitshëm i ulët. Në realitet, kjo sugjeron praninë e mjeteve alternative të financimit të aktivitetit ekonomik siç janë pagesat përmes këmbimit si për shpenzime kapitale ashtu edhe për ato rrjedhëse. Në këtë kuptim, praktikat e këmbimit të ndërtesave banesore në truall për apartamente ose për punët nga ana e nën-kontraktorëve që paguhet përmes të njëjtave mënyra tregon se në të vërtetë ekziston një trend i anashkalimit të sektorit financiar dhe që punohet sipas gjetjeve vetanake. Duke pasur gjithë këtë parasysh, nuk ka asgjë që parandalon fitimet nga aktiviteti i paligjshëm që të hyjnë në sektor përmes skemave të njohura të derës së pasme, urave të financimit apo të ngjashme. Fakti se shitja e parë e hapësirave të banimit nuk tatóhet për TVSH e bën të vështirë gjurmimin e mbylljes së llogarive dhe detyrimeve tatimore të biznesit. Ky tipar i fundit, ndërtimi si i tërë, ndahet me të gjitha bizneset e vogla e veçanërisht në aktivitetin ekonomik të sektorit të Shumicës dhe Pakicës. Numri i punëtorëve joformalë në këtë sektor vlerësohet të jetë në 9,778 me një humbje totale në TAP prej 3.2 mi. € dhe humbje në TAK me 5.2 mil që është 8.4 mil€ në total, pothuajse katër herë më shumë sesa vlerat në bujqësi, ndonëse ndërtimtaria

Spektori Shumicë Pakicë Me gjithë se masat kthyese janë të larta kundrejt standardeve globale (dyfish sa i përket koeficientit dhe 30% në përpjesëtimin Shitje/Kapital) kreditimi i sektorit është pesë herë më i lartë sesa standardet kombëtare.(European, 09.11.2017)

Spektori i patundshmërive, Veprimtarive Financiare dhe të Sigurimit dhe Shërbimet Profesionale: Arsyeja për ekzaminimin e të gjitha këtyre aktivitetëve së bashku në analizën sektoriale ka të bëjë me faktin se operimet biznesore të ndërmarrjeve që punojnë në Kosovë janë plotësuese të njëra-tjetrës. Shërbimet financiare (bankat dhe sigurimet) marrin me qira hapësirat e tyre nga pronarët e pronave në këmbim të pagesës për qira. Qiraja nuk pranohet si shpenzim përveç nëse tatimi në qira ndalet dhe paguhet tek autoritetet tatimore. A njëjta do të duhej të ndodhte edhe kur qiraja që paguhet nga Shërbimet Profesionale që ushtrojnë aktivitetin e tyre në objekte me qira. Duket se autoritetet tatimore shënime për tatimin në qira vetëm për ato biznese apo individë që janë regjistruar për Tatimin mbi Qira që

përkojnë me tatimin e mbajtur në burim. **Për bizneset të cilat nuk dorëzojnë deklaratat financiare në zyrat tatimore duket se tatimin në qira nuk deklarohet, andaj nuk mblidhet.** E njëjta duket se ndodh edhe me ofruesit e shërbimeve profesionale që nuk janë të obliguar të dorëzojnë pasqyrat financiare. **Njëjtë duket se qëndron gjendja edhe me qiranë e paguar nga individët për shërbimet e banimit, që në masë të madhe nuk deklarohet andaj edhe tatimi përkatës mbi qiranë nuk mblidhet.** Dallimi ndërmjet GVA të patundshmërisë dhe Fitimit Bruto të të njëjtit aktivitet në shënimet kontabël të biznesit të TAK është shumë i lartë **gjë e cila sektorin e bën mjaft të cënueshëm ndaj veprimtarive të pastrimit të parasë. Të ardhurat joformale që rezultojnë mbesin të fshehura nga autoritetet tatimore pasi që nuk ka obligim që formularët personal tatimorë të dorëzohen nga të gjithë banorët e Kosovës.** Për pjesën e mbetur të informaliteteve të identifikuar në këto aktivitete, ekziston hapësirë për të rishikuar hendeqet si në TAP dhe në TAK në shërbimet financiare ashtu që të bëhet transferimi i kapitalit përkatës të padeklaruar dhe të ardhurave nga puna drejt ofruesve të shërbimit (kapital ose punë). Metodologjia e zbatuar këtu tashmë jep disa ide se cilat mund të jenë këta sektorë (p.sh hoteleria dhe shërbimet e ushqimit, transporti dhe ruajtja dhe shërbimet e mbrojtjes/sigurimit kanë normë tepër të ulët të KA).(European, 09.11.2017)

2.3 Etika dhe Kodi i Etikës së kontabilistëve – IFAC - Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve

Një shenjë dalluese e profesionit të kontabilitetit është pranimi i saj i përgjegjësisë për të vepruar në interes të publikut. Prandaj, përgjegjësia e kontabilisti profesional nuk është ekskluzivisht për të kënaqur nevojat e një klienti ose punëdhënësi individual. Kur vepron në interes të publikut, një kontabilist profesionist duhet të respektojë dhe të respektojë kërkesat etike të këtij Kodi. Ky Kod është në tre pjesë. Pjesa A krijon parimet themelore të etikës profesionale për llogaritarët profesionistë dhe ofron një kornizë konceptuale për zbatimin e këtyre parimeve. Kuadri konceptual siguron udhëzime mbi parimet themelore etike. Kontabilistëve profesionistë u kërkohet të zbatojnë këtë kornizë konceptuale për të

identifikuar kërcënimet për respektimin e parimeve themelore, për të vlerësuar rëndësinë e tyre dhe, nëse kërcënime të tilla janë të tjera përveç qartë të parëndësishme- të zbatojnë masa mbrojtëse për t'i eliminuar ato ose zvogëluar ato në një nivel të pranueshëm, siç është pajtueshmëria me parimet themelore nuk komprometohet. Pjesët B dhe C ilustrojnë se si korniza konceptuale do të zbatohet në situata specifike. Ai ofron shembuj të masave mbrojtëse që mund të jenë të përshtatshme për të adresuar kërcënimet për respektimin e parimeve themelore dhe gjithashtu jep shembuj të situatave kur masat mbrojtëse nuk janë të disponueshme për të adresuar kërcënimet dhe rrjedhimisht aktiviteti ose marrëdhënia që krijon kërcënimet duhet të shmanget. Pjesa B vlen për llogaritarët profesionistë në praktikën publike. Pjesa C vlen për llogaritarët profesionistë në biznes. Kontabilistët profesionistë në praktikën publike gjithashtu mund të gjejnë udhëzimet në Pjesën C të rëndësishme për rrethanat e tyre të veçanta. Një llogaritar profesionist kërkohet të zbatojë parimet mëposhtme themelore të:

(a) Integriteti

Një llogaritar profesionist duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe i sinqertë në të gjitha marrëdhëniet profesionale dhe afariste.

(b) Objektiviteti

Një kontabilist profesionist nuk duhet të lejojë paragjykimin, konfliktin e interesit ose ndikimin e padrejtë të të tjerëve për të tejkaluar gjykimet profesionale ose të biznesit.(IFAC, 2005)

(c) Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur

Një kontabilist profesionist ka një detyrë të vazhdueshme të ruajë njohuritë dhe aftësitë profesionale në nivelin e kërkuar për të siguruar që një klient ose punëdhënës të marrë shërbimin profesional kompetent bazuar në zhvillimet e tanishme në praktikë, legjislacion dhe teknika. Një kontabilist profesionist duhet të veprojë me zell dhe në përputhje me standardet e zbatueshme teknike dhe profesionale kur ofron shërbime profesionale.

(D) Konfidencialiteti

Një kontabilist profesionist duhet të respektojë konfidencialitetin e informatave të fituara si rezultat i marrëdhënieve profesionale dhe të biznesit dhe nuk duhet të zbulojë çdo informacion të tillë për të palëve të treta pa autoritetin e duhur dhe për të caktuar nëse nuk

ka një të drejtë ligjore apo profesionale, ose detyrimi për të ditur . Informacioni konfidencial i marrë si rezultat i marrëdhënieve profesionale dhe afariste nuk duhet të përdoret për përfitimin personal të llogaritarit profesional ose të palëve të treta.

(e) Sjellja profesionale

Një kontabilist profesionist duhet të respektojë ligjet dhe rregulloret përkatëse dhe duhet të shmangë çdo veprim që diskrediton profesionin.

Secili prej këtyre parimeve themelore është diskutuar më në detaje në Seksionet e tjera. Ky Kod siguron një kornizë për të ndihmuar një llogaritar profesionist për të identifikuar, vlerësuar dhe për t'iu përgjigjur kërcënimeve për respektimin e parimeve themelore. Nëse kërcënimet e identifikuara janë ndryshe nga qartësisht të parëndësishme, një kontabilist profesionist duhet, kur është e përshtatshme, të zbatojë masa mbrojtëse për të eliminuar kërcënimet ose t'i zvogëlojë ato në një nivel të pranueshëm, në mënyrë që përputhja me parimet themelore të mos rrezikohet. 100.6 Një llogaritar profesionist ka për detyrë të vlerësojë çdo kërcënim për respektimin e parimeve themelore kur llogaritari profesionist e di, ose mund të pritët. 100.8 Një llogaritar profesionist mund të shkelë pa dashje një dispozitë të këtij Kodi. Një shkelje e tillë e paqëllimtë, në varësi të natyrës dhe rëndësisë së çështjes, nuk mund të rrezikojë pajtueshmërinë me parimet themelore të parashikuara, pasi të zbulohet shkelja, shkelja korrigjohet menjëherë dhe zbatohen çdo masë mbrojtëse e nevojshme.(IFAC, 2005).

2.4 Profesionistët e kontabilitetit përballë problematikave të evazionit fiskal dhe veprimeve të tjera të paligjshme

Informacioni i kontabilitetit në kushtet e sistemeve informatike sot duhet të jetë ai i orës së fundit, duke paraqitur sa më saktë situatën financiare të biznesit. Nëse kontabilisti apo revizori (eksperti kontabël) luan me shifrat në librat e llogarive duke mos paraqitur situatën e vërtetë financiare të biznesit, kjo do të thotë që ai nuk e bën punën si duhet, apo është futur në rrugën e mashtrimit. Por përgjegjës janë edhe ai që mban kontabilitetin dhe ka

hartuar pasqyrat financiare si edhe ai që ka audituar këto pasqyra. Detyra kryesore e një kontabilisti apo audituesi është të verifikojë dhe të provojë nëse transaksionet e kryera janë të vërteta, po kështu dhe dokumentacioni i hartuar për vërtetimin e tyre. Por profesionisti i vërtetë i kontabilitetit nuk duhet të tërhiqet derisa çështjes t'i shkojë deri në fund. Flasim këtu për profesionistë të vërtetë, të ndërgjegjshëm, që nuk e kanë futur veten në “zullum”. Kur bilanci përgatitet për qëllime huamarrje në një bankë, punohet që pozicioni financiar i njësisë ekonomike të duket mire, kurse në anën tjetër, kur pasqyra financiare është për zyrat e taksave, të ardhurat, detyrimet ndaj tatim-taksave etj. minimizohen ose fshihen. Si realizohet ky manipulim? P.sh., duke rivlerësuar inventarët në ulje apo në rritje sipas nevojës për të ulur apo rritur shpenzimet, duke mos pasqyruar drejt kostot e hyrjes apo duke mos zbatuar metodat e vlerësimit Fifo apo Mesatare sipas Standardeve të Kontabilitetit etj.(Agim Binaj, 2016). Të bësh punën e kontabilistit do të thotë të zbatosh rregullat, standardet dhe kodin e etikës. Duke zbatuar e zhvilluar mirë këto përgjegjësi profesionisti i kontabilitetit rritet, bëhet më profesional, ndihet më i sigurt në tregun e punës, krijon emër të mirë (famë), një aset me vlera të veçanta ky, që maksimizohet çdo ditë në kapitalin intelektual të investuar. Kur kontabilisti harton pasqyrat financiare dhe përdoruesit e tyre janë dashamirës, e informacioni është i vërtetë, nuk ka asnjë problem. Por nëse nga përdoruesit informacioni i kërkohet kontabilistit të jetë jo i vërtetë, se kështu ua kërkon interesi, atëherë profesioni i kontabilistit është kthyer në “tregti”. Pra, që ky produkt, informacioni kontabël, shitet dhe blihet si një mall i zakonshëm. Sidoqoftë, nëse njëra palë mashtron (kontabilisti), duke shitur një produkt (Pasqyrat Financiare) që nuk është ai që duhet të jetë, por ndryshe, efekti i të qenit mirë i të dy palëve është minuar. Mashtrimi zakonisht fillon nga ai që ka produktin ose mallin dhe e shet atë (Pasqyrat financiare), pra nga pala që shet diçka ndryshe dhe më pak të vlefshme se sa blerësit presin(përdoruesit e informacionit kontabël). Është e rëndësishme të theksojmë këtu se: Të gënjeshtër në këtë rast nuk është njësoj me të thënë e diçka je të pasaktë apo false. Gënjeshtër në profesionin e kontabilistit përfshin një keq prezantim të qëllimshëm të diçka je, të një subjekti tjetër në një mënyrë sa më të padyshimtë, që gënjeshtari duket se e gjen të përshtatshme dhe që i gënjyeri (institucioni bankar apo dikush tjetër) ta besojë vërtet mashtrimin, apo për qëllimet e veta të bëjë sikur e beson. kontabilistët apo profesionistët e kontabilitetit themi se nuk

duhet të përfshihemi në evazion fiskal, të gënjejme, nuk duhet të mashtrojmë me shifrat, sepse nëse e bëjmë këtë njerëzit nuk do të na besojnë më, nuk duhet të nënshtrohet dhe të bjerë në llumin e mashtrimit për hir të disa fitimeve. Duhet theksuar se, qysh në fillimet e profesionit të kontabilistit në shekullin e 15të, qëllimi ka qenë për të dhënë një pamje të vërtetë dhe të saktë të gjendjes financiare të njësisë ekonomike (ndërmarrjes). Hartimi i një pamje të rreme, përbën një shtrembërim të funksionit të kontabilistit, e çon atë në krizë, në krizën e besimit. Po si ti shmangim këto fenomene edhe në mesin tonë? Përgjigja është ajo çka cituam më lart: “Profesionisti i kontabilitetit të bëjë punën e tij”. Kjo përmbush një përmbajtje të madhe të përgjegjësive specifike, të lexuara rrokje më rrokje në çdo përshkrim të punës. Në kodin etik të jetës së kontabilistit apo profesionistit të kontabilitetit shkruhet: “Përgjegjësinë e punës së tjetrit duhet ta ndjesh njëlloj sikur ajo është puna jote, si pjesë e jetës tënde, si çmimi më i madh i jetës tënde”. Profesionistët e kontabilitetit, nëpërmjet teknologjisë së informacionit, duhet t’i përsosin njohuritë e tyre jo vetëm në teknikat e kontabilitetit, por edhe në teknikat për të zbuluar dhe parandaluar manipulimet e mashtrimit në raportimin financiar.(Agim Binaj, 2016)

2.5 Masat parandaluese dhe luftimi i ekonomisë informale

- *Ministria e Pushtetit Lokal* – Komunat si Institucionet që janë më afër qytetarëve dhe tatimpaguesve që ushtrojnë bizneset e tyre, pasi që kapacitetet operative dhe mbikëqyrëse të zbatimit të ligjeve (*inspeksionet e tregut, të punës, sanitare, ndërtimore, etj.*) mund të jenë shumë të dobishme dhe me interes të madh në luftimin e ekonomisë joformale.
- Krijimi i Njësitit të përbashkët të Inteligjencës (*me pjesëmarrësit e Institucioneve relevante – MPB, ShPK, Dogana, Prokuroria, ATK, etj.*), do të jetë burimi kryesor i ndërlidhjes së Institucioneve përgjegjëse për luftimin e aktiviteteve të ekonomisë joformale. Efikasiteti i këtij Institucioni varet shumë nga baza ligjore e ndërtimit dhe pasurimit me përgjegjësi si dhe mbikëqyrja e këtij Organi.

- Rishikimi i legjislacionit dhe sqarimi i rolit të autoriteteve të ndryshme për bashkëpunimin e ndërsjellë, shkëmbimin e informatave, aktivitete të përbashkëta operative etj, do të jenë shumë të dobishme për zgjerimin e bazës tatimore dhe shtimin e numrit të tatimpaguesve,
- Fuqizimin e Njësitit të Përbashkët të Inteligjencës, përdorimin e TI si mjet i fuqishëm për furnizimin e institucioneve relevante për luftimin e dukurive të ekonomisë joformale si dhe krijimi i programit trajnues gjithëpërfshirës është mundësi e mirë e krijimit të kuadrit profesional, të përgjegjshëm dhe të besueshëm.
- Duhet mundësuar shkëmbim të informacioneve ndërmjet bazave të të dhënave të Doganave, Prokurorive dhe Policisë me qëllim të rritjes së manovrimit me informacione përkitazi me parandalimin e krimit, garantimit të procesit të duhur ligjor dhe mbrojtjes së të dhënave.
- Duhet konstituuar strategji të përbashkët trajnimi të autoriteteve administrative, zbatuese të ligjit dhe atyre gjyqësore sikurse edhe sektorit privat ashtu që hetime efikase të mund të bëhen në rastet e krimeve financiare dhe ekonomike dhe krimeve të korrupsionit
- Funksionet e hetimit special të gjurmëve të pasurisë,
- Zyrat e prokurorive dhe gjykatat duhet të kenë personel të specializuar për proceset që kanë të bëjnë me krimet serioze financiare etj.

E tëra duhet të shoqërohet më një kampanjë informative dhe të karakterit edukativë me kategori që pësojnë direkt nga kjo dukuri si: punëtorët, qytetarët etj, për dëmet që sjellin aktivitetet e ekonomisë joformale si dhe me shqyrtimi i kapaciteteve profesionale të Institucioneve përgjegjëse.

3 Te Hyrat Tatimore te grumbulluara nga ATK dhe DOGANA


Qeveria e Republikës së Kosovës është në vazhdimësi e orientuar drejtë stabilitetit makro – fiskal andaj edhe niveli i deficitit buxhetor vazhdon të jetë i ulët duke siguruar rezerva të mjaftueshme buxhetore dhe shmangie të akumulimit të tepruar të borxhit publik. Një mjedis i tillë, i qëndrueshëm makro-fiskal, favorizon rritjen ekonomike që vjen kryesisht si rezultat i aktivitetit të sektorit privat.

Dokumenti i KASH-it në vazhdimësi është bazuar në ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të kornizës fiskale të bazuar në rregulla fiskale shumë të rëndësishme, duke përfshirë rregulla që kërkojnë:

- Rishikime buxhetore me ndikim neutral në deficit;
- Kufizim të deficitit buxhetor në 2% të BPV-së;
- Kërkesën që fatura e pagave publike të ketë pjesëmarrje konstante në raport me BPV-në nominale;
- Kufizim të borxhit prej 40% të BPV-së, gjegjësisht 30% për përjashtimin e investimeve kapitale nga rregulla e deficitit, sipas “klauzolës së investimeve”.

Përjashtimi nga kufizimi i deficitit për projektet kapitale të financuara nëpërmjet huadhënies afatgjate dhe koncesionare të donatorëve, ose atyre të financuara nga likuidimi i aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, ofron hapësirë të mjaftueshme për të trajtuar nevojat për investime kapitale brenda një kornize të kujdesshme dhe të shëndoshë fiskale.

Figura 1. Struktura e te hyrave ne te hyrat e përgjithshme



Burimi: Raporti vjetori ATK nga viti 2016-2022

Në tabelën në vazhdim janë paraqitur të hyrat sipas tatimeve për vitin 2017-2020 si dhe projeksionet për vitet 2021 dhe 2022. Ashtu si edhe nga grafiku më lartë edhe në tabel shihet se të hyrat kryesore të buxhetit të Kosovës janë nga tatimet indirekte dhe atë TVSH dhe Akciza të ciat edhe marrin pjesë me mbi 76% në buxhetin e përgjithshëm të vitit fiskal.

Tabela 1. Te hyrat sipas llojeve te tatimeve dhe te hyrat tjera jo tatimore

Pershkrimi	2017	2018	2019 Buxhet	2020 Proj.	2021 Proj.	2021 Proj.
Në milion Euro						
GJITHSEJ TË HYRAT BUXHETORE	1,684	1,757	1,949	2,060	2,159	2,276
<i>Nga të cilat: nga ulja e stokut te borxhit tatimor</i>			27	27	27	27
<i>Nga përmirësimi i përbushjes tatimore</i>			14			
1.1 Te hyrat tatimore	1,496	1,564	1,730	1,824	1,924	2,032
Tatimet direkte	238	268	288	310	327	347
<i>Tatimet në të ardhurat e korporatave</i>	75	87	91	100	105	110
<i>Tatimi në të ardhurat personale</i>	137	153	163	173	182	192
<i>Tatimi në pronë</i>	22	24	30	33	37	41
<i>Të tjera</i>	3	4	4	4	4	4
Tatimet indirekte	1,315	1,344	1,492	1,564	1,648	1,737
<i>Tatimi mbi vlerën e shtuar</i>	756	799	905	941	989	1,048
<i>Vendore</i>	198	213	258	267	273	288
<i>Kufitare</i>	558	586	647	675	716	760
<i>Detyrime doganore</i>	126	124	120	132	142	152
<i>Akcizë</i>	432	419	465	488	511	533
<i>Të tjera</i>	1	2	2	2	5	5
<i>Të hyrat e njehershme nga borxhi i NSH</i>	0	0	0	0	0	0
<i>Të hyrat e njehershme nga norxhi i NP</i>	0	0	0	0	0	0
Rimbursimet tatimore	-58	-48	-50	-50	-51	-52
1.2 Të hyrat jo- tatimore	188	193	208	226	224	233
<i>Taksa, ngarkesa dhe të tjera- Niveli Qendror</i>	103	110	103	126	120	127
<i>Taksa, ngarkesa dhe të tjera- Niveli Lokal</i>	43	46	57	50	50	50
<i>Taksa koncesionare</i>	9	9	11	13	17	20
<i>Renta Minerare</i>	31	25	33	33	33	33
<i>Të hyrat nga liberalizimi i tregut te telefonisë mobile</i>	0		0	0	0	0
<i>Të hyrat nga dividenda</i>	0	0	0	0	0	0
<i>Te hyrat nga interesi (NP-ve)</i>	3	2.1	4	4	4	3

Kosova ka zhvilluar një sistem fiskal të bazuar në përvojat dhe politikat më të mira të Bashkimit Evropian, në mënyrë që të ketë politika fiskale dhe legjislacion sa më të përafërt me atë të BE-së. Kjo vlen për tatimet dhe politikat doganore duke përfshirë tatimet direkte dhe indirekte (Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, Tatimi në të Ardhurat Personale, Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, Dogana, Akciza, etj).

Sistemi tatimor në Kosovë përbën një pako ligjesh tatimore dhe udhëzimesh administrative.

- Tatimit në të Ardhurat e Korporatave (TAK);
- Tatimit në të Ardhurat Personale (TAP);
- Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH);
- Detyrimeve Doganore;
- Akcizës;
- Dispozitat e Veçanta;
- Transferimi i Çmimeve;
- Shmangies së tatimit të dyfishtë.

Kto lloje të tatimeve bazohen në ligjet relevante në fuqi të cilat zbatohen nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës.

Tabela.2. Normat tatimore në Kosovë

Lloji i tatimit	Pragu i qarkullimit	Norma tatimore
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar - TVSh	30,000 euro	8% dhe 18%
Tatimi në të Ardhura të Korporatave - TAK Veprimtaria prodhuese, tregtare dhe transportuese, etj. Veprimtaria shërbyese	nën 50,000 euro	3% 9%
Tatimi në të Ardhurat Personale - TAP Veprimtaria prodhuese, tregtare dhe transportuese, etj. Veprimtaria shërbyese	nën 50,000 euro	3% 9%
Tatimi në të Ardhura të Korporatave - TAK	mbi 50,000 euro	10%
Tatimi në të Ardhurat Personale - TAP Të ardhurat Vjetore nga 0 deri 960 Të ardhurat Vjetore nga 960 - 3000 Të ardhurat Vjetore nga 3,000 deri 5,400 Të ardhurat Vjetore nga 5,400 e tutje	mbi 50,000 euro	0% 4% 8% 10%
Tatimi në Paga (mujor) Të ardhurat mujore nga 0 deri 80 Të ardhurat mujore nga 80 - 250 Të ardhurat mujore nga 250 - 450 Të ardhurat mujore nga 450 e tutje		0% 4% 8% 10%
Tatimi në Qira, Interes dhe të drejta pronësore		10%
Tatimi për kategori të veçanta		3%
Tatimi për jo-rezidentët		5%

Burimi: Normat tatimore ATK 2016

Taksa doganore është 0% - 10% Shumica e lëndëve të para janë të liruar, Shumica e pajisjeve për prodhimin janë të liruar me Ligjin Nr. 04/L-163.

Disa nga materialet e papërpunuara bujqësore (të tilla si farat, etj.) dhe pajisjet janë të liruar nga Dogana dhe TVSH-ja. Janë bërë lirimet edhe me zgjerimin e aneksit të Ligjit Nr. 04/L-163 publikuar me 16.01.2014

Udhëzimin Administrativ 05/2015 të datës 30.09.2015 shtohet aneksi 1 ku behet lirimi i barnave kreut të 30 si dhe Gazi natyral dhe LPG për energji.

Udhëzimin Administrativ 07/2016 të datës 12.10.2016 shtohet Lista e mallrave me tatim zero e cila i shtohet Aneksit 1, Pjesa B dhe Pjesa D të Ligjit ku lirohen mallrat; Koks naftë i kalcinuar, Vajrat si lëndë djegëse, si dhe vajrat lubrifikante.

4 DEKLARIMI I PROBLEMIT

Duke pasur parasysh faktin se evazionifiskal është dukuri jashtëzakonisht negative për një ekonomi dhe ajo jo vetëm se shkakton një buxhet më të vogël për shtetin por në mënyrë multiplicative ndikon në nxitjen e fenomeneve të tjera të cilat e shoqërojnë ndikimin negative për shtetin siç është konkurrenca jolojale mes bizneseve, dëmtimin e punëtorëve për të cilët nuk paguhet kontributi pensional si një siguri materiale për moshën e pleqërisë. Gjithashtu evazoni fiskal inkurajon edhe korrupsionin, kjo për arsye se ndërmarrjet të cilat deklarohen më pak ose fshehen tashmë ato mund të bashkëpunojnë me zyrtar administrativ sikur me inspektor tatimor, doganor, inspektor të punës, sanitar dhe në të gjithë portet institucionale.

Duke pas në konsiderat këtë dukuri si fenomen negativ për shoqërinë ndërsa në anën tjetër për të identifikuar se cili është ndikimi negativ për ekonomin dhe po ashtu gjetja e mekanizmave për të matur evazionin fiskal në njërin anë dhe në anën tjetër për të identifikuar strategjitë për luftimin e evazionit apo planifikimet për aktivitete të ndryshme në identifikim, luftimin dhe zvogëlimin e kësaj dukurie janë pikërisht fokusimi në temën e diplomës.

Duke dit se shumica apo gati se të gjithë bizneset i mbajnë librat dhe regjistrimet përmes kontabilistëve të çertifikuar, ndërsa të njejtë janë kontakti i parë i cili edhe identifikon apo është më afër mundësisë për të dit se biznesi në të cilin ai mban librat dhe regjistrimet ka tendencë për evazion apo jo. Në këtë punim po ashtu jam përqëndruar për të identifikuar ndikimin e kontabilistëve se sa ata mund të kontribuojnë për të këshilluar apo edhe ndikuar që ndergjegjesimi i ndërmarrjeve të jetë i tillë që të shmangen nga ideja për evazion duke i ditur ndikimet negative për shtetin në përgjithësi dhe edhe për vetë biznesin në veqanti.

Prandaj përmes fakteve shkencore, krahasimeve empirike nga vende të ndryshme dhe politikave të përdorura në këto vende në këtë punim do të nxjerr rekomandime dhe konstatime për të ndihmuar në gjetjen e metodave për luftimin e evazionit fiskal.

5 METODOLOGJIA

Metodologjia që është aplikuar gjatë hartimit të këtij punimi është përcaktuar nga vetë qëllimi i hulumtimit. Si fillim, është përdorur metoda përshkruese, për të dhënë një informacion teorik, dhe jo vetëm mbi ligjin, por dhe mbi situatën në përgjithësi në vend. Gjatë hartimit të këtij punimi është shfrytëzuar literatura shkencore e një spektri të gjerë që ka të bëjë me fushën e evazionit fiskal, etikës së kontabilistëve, kodin e etikës së kontabilistëve si dhe profesionistët e kontabilitetit përballë problematikave të evazionit fiskal dhe veprimeve të tjera të paligjshme. Burim informacionit kanë qenë edhe bibliotekat elektronike të universiteteve të ndryshme perëndimore, adresat e ndryshme elektronike të institucioneve financiare ndërkombëtare, si dhe informacione zyrtare në lidhje me krimin financiar. Punimet akademike, kërkimet shkencore, punime konferencash ose edhe leksione mbi fushën kërkimore, kanë plotësuar kuadrin e burimeve dytësore. Modeli është zgjeruar duke përfshirë analizën empirike të efektit të krimeve ndaj situatës ekonomike të vendit. Burimi kryesor i të dhënave për këtë model ka qenë ATK në mënyrë online përmes raporteve të cilat ata i kanë publikuar në përgjithësi për të gjithë Kosovën janë të paraqitura në tabela. Gjithashtu për të pas një opinion mbi evazionin fiskal dhe etikën e kontabilistëve në evazionin fiskal është përgatitur një pyetësor i cili është shpërndarë te 50 respondent kryesisht kontabilist, gjithashtu një numër i vogël i respondentëve ishin pronar të bizneseve të vogla ku në përgjigjet në 10 pyetje është analizuar opinioni i tyre mbi evazionin fiskal etikën e kontabilistëve si dhe sektorët në të cilët evazoni fiskal është më i pranishëm. Përmes analizës empirike të statistikave por edhe përmes pyetësorit është arritur një kombinim i metodës kuantitative dhe kualitative për të arritur rezultatet sa më të besueshme dhe të sakta.

Pyetja themelore hulumtuese që është adresuar në këtë punim është:

Cilat janë problemet e shfaqjes së evazionit fiskal në Kosovë? Ndërsa kemi zgjedhur dy hipoteza për të i vertetuar dhe ato:

Ha: Normat tatimore janë të larta në Kosovë dhe i referohen evazionit fiskal.

Ho: Normat tatimore janë të ulëta në Kosovë dhe nuk ka raste të evazionit fiskal.

6 MBLEDHJA E TE DHENAVE DHE REZULTATET

Rezultatet nga pyetësori

Për hulumtimin e këtij punimi janë përdorur të dhëna sekondare, të marruara nga burimet e institucioneve relevante si dhe të dhëna primare nga pyetësori për respondentët.

Në pyetësorin e përdorur mostra ka qenë e rastësishme. Edhe pse nuk është faktor shumë i rëndësishëm që ndikon në matjen e pyetjeve kërkimore nga pjesëmarrësit në hulumtim kemi pasur 12 femra dhe 38 meshkuj, apo shprehur në %, 24 % me 76 %.

Element i rëndësishëm për hulumtimin tonë ka qenë se këta pjesëmarrës qfarë profesioni ushtrojnë edhe pse ne jemi kujdesur që kryesisht të intervistojmë kontabilist që janë aktiv në mbajtje të librave gjë që edhe shumica prej tyre janë të kësaj kategorie ndërsanjenumeri i vogël i tyre ishin edhe pronar të bizneseve Shprehur në numra , 42 respondent ishin kontabilist dhe vetëm 8 nga ta edhe pronar të bizneseve ashtu si edhe është prezantuar në grafikun në vazhdim.




Figura 2. Profesioni i respondentëve

Tabela.3. Evazoni fiskal në Kosovë është shumë i lartë?

Respodent	%	Deklarimi
43	86%	Pajtohem plotësisht
8	16%	Pajtohem
0	0%	Nuk pajtohem




Figura 3. Evazoni fiskal në Kosovë.

Tabela.4. Evazoni Fiskal është shumë i lartë te bizneset e vogla?

Respodent	%	Deklarimi
13	26%	Pajtohem plotësisht
28	56%	Pajtohem
9	18%	Nuk pajtohem




Figura 4. Evazoni në bizneset e vogla.

Tabela.5.Bizneset me qarkullim dhe numër të madhe të puntorëve kan më pak evazion fiskal?

Respodent	%	Deklarimi
0	0%	Pajtohem plotësisht
14	28%	Pajtohem
36	72%	Nuk pajtohem




Figura 5. Bizneset me qarkullim.

Tabela.6.Evazoni më i madh është në sektorin e hotelerisë?

Respodent	%	Deklarimi
20	40%	Pajtohem plotësisht
27	54%	Pajtohem
3	6%	Nuk pajtohem




Figura 6. Evazoni në sektorin e hotelerisë.

Tabela.7.Etika fiskale në mbajtjen e librave dhe kontabiliteti është i imponuar nga biznesi?

Respodent	%	Deklarimi
26	52%	Pajtohem plotësisht
24	48%	Pajtohem
0	0%	Nuk pajtohem




Figura 7. Etika Fiskale

Tabela.8.Kontabilisti ka ndikimi në evasion fiskal?

Respodent	%	Deklarimi
0	0%	Pajtohem plotësisht
10	20%	Pajtohem
39	78%	Nuk pajtohem




Figura 8. Ndikimi i Kontabilistit në evazion fiskal.

Tabela.9.Biznesi i pranon keshillat për etik fiskale dhe mbajtjen librave dhe kontabiliteti në menyre korrekte?

Respodent	%	Deklarimi
0	0%	Pajtohem plotësisht
19	38%	Pajtohem
41	82%	Nuk pajtohem




Figura 9. Këshillatpërbiznesin.

Tabela.10. A mendoni se kontabilisti mund te ndikoj në zvogelimin e evazionit fiskal?

Respodent	%	Deklarimi
8	16%	Pajtohem plotësisht
29	58%	Pajtohem
14	28%	Nuk pajtohem

Figura 10. Ndikimi i Kontabilistit




Tabela.11.A mendoni se ndëshkimi edhe i kontabilistit për evazion fiskal mundet me kontribu në zvoglimin e shmangjeve tatimore?

Respodent	%	Deklarimi
8	16%	Pajtohem plotësisht
26	52%	Pajtohem
16	32%	Nuk pajtohem





Figura 11. Zvoglimi i shmangjeve tatimore

Tabela.12.A mendoni se evazoni fiskal po ndihmohet edhe nga inspektorët që mbajnë libra dhe kontabilitet?

Respodent	%	Deklarimi
28	56%	Pajtohem plotësisht
15	30%	Pajtohem
7	14%	Nuk pajtohem

Figura 12. Ndikimi i inspektorëve.



7 DISKUTIME, PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Për ta përmbledhur, kërkimet mbi evazionin fiskal duhet të marrim parasysh që tatimpaguesit jo vetëm që duan të maksimizojnë interesat e tyre, sido që të përcaktohen, por gjithashtu dëshirojnë të shohin drejtësi dhe drejtësi të realizuar.

Barra e taksave, një nga shumë faktorët që kontribuon të evazionin fiskal, është në plan të parë aty ku politikat publike duhet dhe shumë shpesh janë, shënjestruar në mënyrë që të ndryshojnë një sistem që nxit angazhimin në evazionin fiskal dhe mashtrimin. Barra e taksave lidhet jo vetëm me shumën e paguar por gjithashtu në lehtësimin e vështirësive për pagimin e taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore. Mos-lëshimi i kuponit tatimor dhe evazioni fiskal në Kosovë janë arsyeja që kanë çuar në parregullsitë e konstatuara nga autoritetet fiskale.

Inkurajimi i individëve që të deklarojnë dhe paguajnë taksat e tyre me kohë, ka të bëjë me një ndërthurje të stimujve dhe sanksioneve. Këto të fundit tradicionalisht kanë qenë në qendër të strategjive të mbledhjes së taksave, d.m.th., procedurave të zbatimit të taksave, përfshirë tarifrat dhe gjobat. Institucionalizimi i një qasjeje të sjelljes ndaj mbledhjes së taksave mund t'i lejojë Kosovës të zhvillojë investime që janë efektive në nivel lokal me kosto të ulët dhe me vetëm kërkesa modeste në burimet administrative dhe njerëzore. Krijimi i një ekipi që kryen vlerësime të rrepta jo vetëm që do të ndihmojë në identifikimin e asaj që funksionon, por gjithashtu do t'u mundësojë krijuesve të politikave të kuptojnë sjelljen e tatimpaguesit.

Luftimi i evazionit fiskal do të sillte gjëra shumë të mira për shtetin e Kosovës duke rritur të ardhurat buxhetore dhe duke ndikuar në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe mirëqenien sociale të vendit. Reformat tatimore në Kosovë janë të domosdoshme si në aspektin e politikës tatimore po ashtu edhe në aspektin profesional nga organet tatimore dhe si përfundim për zbatimin sa më të efektshëm të reformave tatimore duhet të vazhdohet të punohet më shumë në përmbushjen e disa parakushteve: të sigurohet infrastruktura institucionale; aftësimi profesional i stafit të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) me anë të trajnimeve të ndryshme me ekspert ndërkombëtar; shkëmbimi i përvojave me institucionet tatimore të vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim që e kanë kaluar

fazën e tranzicionit vetëdijesimi i obliguesve tatimor apo parimi i vet-deklarimit, etj. Çelësit i suksesit të luftës ndaj evazionit fiskal do të ishte ndërgjegjësimi i tatimpaguesve së të paguarit e detyrimit tatimor do të thotë zhvillim, mirëqenie, hapa përpara drejt integritetit. Gjithashtu është e nevojshme garantimi i sigurisë, së tatimet e paguara nga tatimpaguesit do të përdoren drejt dhe me efikasitet në të mirë të publikut nga ana e qeverisë dhe e pushtetit vendor.

8 REFERENCAT

- Asprey, K. W. (2001). *Taxation Review Committee*. Sydney.
- Administrata Tatimore e Kosovës- ATK.(2018). *Raport vjetor*. Gjetur në <http://www.atk-ks.org/wp-content/uploads/2019/04/ALBRaportiVjetor2018.pdf> . Qasur më: 06.10.2020
- Alm, J. (2012). *Measuring, explaining, and controlling tax evasion*. New Orleans, LA. Agency. The World Bank (2020) Qasur më: 25.10.2020.
- Binaj, A & Kalemi, F (2016). Auditimi publik. *Revistë kërkimore, shkencore, informative*.
- Brummerhoff, D. (2000). *Financat publike*.
- Braithwaite, V. (2017). *Taxing Democracy Understanding Tax Avoidance and Evasion*.
- Clotfelter, C. (1983). *Evazioni fiskal dhe nivelet e taksave*.
- Eichengreen, B. (2003). Restructuring Sovereign Debt. *Journal of Economic Perspectives*.
- European, P. (09.11.2017). *Mbështetje e mëtejme insitucioneve të Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm* . Asistenca teknike e bashkimit Evropian për Kosovë.
- Freedman, J & Loomer, G & Vella, J. (2008). *Corporate Tax Risk and Tax Avoidance*:
- Hernandez, M & Karver, J & Negre, M & Perng, J (2019). *Promoting tax compliance in Kosovo with behavioral insights. International Development*
- IFAC.(2005). Gjetur në ifac: <https://www.ifac.org/system/files/publications/files/ifac-code-of-ethics-for.pdf> Qasur më: 14.11.2020
- Kulic, K. (1999). *Evazioni fiskal dhe kontrabanda*.
- Komoni, S. (2008). *Financat publike*. Prishtinë.
- Mascagni, P. (2015).
- Mineva, D & Stefanov, R. Research EOOD. (2018). *European Platform Undeclared Work*.
- Tolger, B. (2012). *Accounting Analysis Journal*.. Gjetur në *Evasion of Taxes and Social Security Contributions*:

- Nobes, C. (2000). *Reformat e ardhshme të taksave në vendet para anëtarësimit në Bashkimin Evropian.*
- Stiglitz, J. (2004). *Ekonomia e sektorit publik.*
- Szerenyi, L. (2003). *Ekonomia gri ne OECD.*
- Sandmo, A. (2012). *International Tax and Public Finance.*
- Thuronyi, V. (2003). *Ligji i taksave krahasuese.*

9 APPENDIXES

Pyetësori



Kolegji UBT
Drejtimi: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Ky pyetësor është përpiluar në funksion të të kuptuarit të ndikimit dhe etikës së kontabilistëve në evazionin fiskal në Kosovë.

Duke pas në konsiderat se egziston një hezitim për të u identifikuar ne do të e rrespektojm plotësisht kërkesën e juaj dhe ju sigurojm se pyetësori është plotësisht anonim.

Të dhënat do të përdoren vetëm për qëllim të hulumtimit. Përgjigjet tuaja të sinqerta do të më ndihmonin për punimin e temës sime të diplomes në kuadër të Universitetit UBT.

Paraprakisht, më lejoni të ju falënderoj për përkrahjen dhe kontributin tuaj.

Me respekt,

Nafije Berisha

1. Evazoni fiskal ne Kosovë është shumë i lartë?

Pajtohem plotësisht

Pajtohem

Nuk pajtohem

2. Evazoni Fiskal është më I lartë te bizneset e vogla?

Pajtohem plotësisht

Pajtohem

Nuk pajtohem

3. Bizneset me qarkullim dhe numër të madhe tëpunorëve kan më pak evasion fiskal?

Pajtohem plotësisht

Pajtohem

Nuk pajtohem

4. Evazoni më i madhe është në sektorin e hotelerisë?

Pajtohem plotësiht

Pajtohem

Nuk pajtohem

5. Etika fiskale në mbatjen e librave dhe kontabiliteti është i imponuar nga biznesi?

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem
- Nuk pajtohem

6. Kontabilisti ka ndikimi në evazion fiskal?

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem
- Nuk pajtohem

7. Biznesi i pranon këshillat për etik fiskale dhe mbajtjen librave dhe kontabilitetit në mënyrë korrekte?

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem
- Nuk pajtohem

8. A mendoni se kontabilisti mund të ndikoj në zvogëlimin e evazionit fiskal?

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem
- Nuk pajtohem

9. A mendoni se ndëshkimi edhe i kontabilistit për evazion fiskal mundet me kontribu në zvogëlimin e shmangjeve tatimore?

- Pajtohem plotësisht
- Pajtohem
-

Nuk pajtohem

10. A mendoni se evazioni fiskal po ndihmohet edhe nga inspektorët që mbajnë libra dhe kontabilitet?

Pajtohem plotësisht

Pajtohem

Nuk pajtohem

Faleminderit për kohën dhe ndihmën tuaj.